



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jednina Org Unit	02
Nr.Prot. Ser Prot Prot.No	05-6459
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 2 -
Data: Datum:	20/08/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

Prishtinë, 20.08.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), në zbatim të dispozitave të nenit 49,50,51,52,53,54 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, nxjerr këtë:

Qarkore Informative Nr: 3/2024

Për: Drejtoritë Komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

Qëllimi: Zbatimi i Rregullores (QRK) - Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës.

- Rregullorja Nr. 09/2015 për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm në Republikën e Kosovës, grupet sektoriale në ministritë përkatëse janë mekanizmi i vetëm për koordinim të asistencës së donatorëve të jashtëm;
- Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për shkëmbim të rregullt të informatave për sa i përket aktiviteteve, planeve dhe iniciativave të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të donatorëve të jashtëm;
- Një nga obligimet kryesore e këtij mekanizmi është verifikimi i të dhënave të raportuara nga ana e donatorëve të jashtëm;
- Meqenëse komunat në vazhdimësi pranojnë donacione për shëndetësi, me qëllim të koordinimit më të mirë dhe krijimit të një pasqyre të qartë të vlerës së donacioneve të ofruara në shëndetësi në nivel nacional që do të reflektohet në Llogaritë kombëtare të shëndetësisë, ju lutem që pranimin donacioneve ta bëni si në vijim:

Obligimet e institucioneve shëndetësore :

- Kërkesat tuaja për pranim të donacionit duhet të vijnë për aprovim duke u drejtuar te zyrtari përgjegjës për donacione në Ministri të Shëndetësisë (Raimonda Dreshaj) dhe pastaj procedohen për aprovim në Komisionin e donacioneve;
- Në momentin kur aprovohen nga komisioni i donacioneve, donacioni mund të pranohet nga Komuna;
- DSHMS të përgatisin raport për donacionet e pranuar gjatë periudhës 2021-2024, dhe ti dërgojnë në Ministri të Shëndetësisë;

Dr. Naim Bardhi

Sekretar i Përgjithshëm



Qarkorja i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Drejtorëve të DSHMS në Komuna;
- Departamentit për integrim evropian dhe koordinim të politikave
- Divizioni për KPSH në Ministri
- Arkivët